



Keqtrajtimi eshte i padrejte Ne te gjitha gjuhët e botes

Abuse is wrong in any language

La violence est inacceptable peu importe la langue

虐待是有悖文明的恶行。

El abuso es condenable en cualquier idioma

ਦੁਰਵਿਵਹਾਰ ਕਿਸੇ ਵੀ ਬੋਲੀ ਵਿੱਚ ਨਜ਼ਾਇਜ਼ ਹੈ

Az erőszak minden nyelven helytelen

Zlostavljanje je zločin na svim jezicima

Violența este inacceptabilă în orice limbă

Týrání je nepřijatelné v každém jazyce



Të Dhëna Kataloguese dhe Botuese për Kanadanë Cataloguing in
Publication Data

Hyrja kryesore nën titullin:

Keqtrajtimi është i padrejte Ne të gjitha gjuhët e botes

Botuar edhe në frëngjisht nën titullin:

La violence est inacceptable peu importe la langue

ISBN 0-662-23089-2

Cat. no J2-131/1995E

1. Keqtrajtimi i gruas - Canada

2. Gratë imigrante – Krimet kundër — Kanada

3. Kanada. Ministria e Drejtësisë

HV6626.23C3A38 1995 362.829'2'0971 C95-980093-X

Ky është një projekt Publik për Edukimin dhe Informimin Ligjor, i realizuar në bazë të Nismës Kundër Dhunës Familjare të Ministrisë së Drejtësisë.

Botuar nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm të Kanadasë

nga

Ministria e Drejtësisë e Kanadasë

Ottawa, Ontario

K1A 0H8

JUS-677E (Botim i Rishikuar)

© Ministri i Punëve Publike dhe Shërbimeve Qeveritare të Kanadasë 2006

Shtypur në Canada

Këtë broshurë mund ta fotokopjoni pa lejen e Ministrisë së Drejtësisë, me kusht që materjali të riprodhohet saktë dhe të përfshihet edhe njohja e prejardhjes së materjalit. Lejë me shkrim nga Ministria kërkohet vetëm në rast se materjali përdoret në ndonjë format tjetër.

(Albanian)

Pasqyra e Lëndës

Mirënjohje	2
Rreth kësaj broshure.	3
Ç'farë përbën abuzim?	4
Mund të kërkoni ndihmë.....	6
Ku mund të gjeni informacion të mëtejshëm?.....	7
Nuk jeni vetëm	7
Nuk është faji juaj	8
Fëmijët tuaj kanë nevojë për mbrojtje	9
Më mirë të qëndroni apo të largoheni?	9
Ç'ndodh nëse vendosni të rrini?	10
Kush e merr kujdestarinë e fëmijëve?	11
A ju heqin nga Kanadaja po t'i shmangeni gjendjes abuzive?	12
A ju heqin nga Kanadaja nëqoftëse prishet sponsorizimi?.....	13
Çfarë ndihme mund t'iu ofrohet?.....	13
Çfarë ndodh nëse...?.....	14
Abuzimi fizik nuk është i vetmi lloj abuzimi.....	16
Kur iu keqtrajtojnë.....	16
Çfarë duhet të merrni me vete kur të largoheni?.....	17
Shprehje të përdorura në këtë broshurë.....	18
Listë e burimeve të komunitetit	20

Mirënjohje

Departamenti i Drejtësisë dëshiron të falënderojë Edukimin Ligjor Publik dhe Shërbimin Informativ të New Brunswick që na dha mundësinë për të botuar këtë material.

Departamenti i Drejtësisë gjithashtu dëshiron të falënderojë dhe të njohë ndihmesën e PLEI Network; kolegët dhe avokatët në province; Ministrinë e Qytetarisë dhe Imigracionit të Kanadasë, Departamentin Kanadez të Trashëgimisë; Ministrinë e Shëndetsisë të Kanadasë; Zhvillimin e Burimeve Njerëzore të Kanadasë; Prokurorinë e Përgjithshme të Kanadasë; dhe Statusin e Grave në Kanada. (Shënim: Emrat e Departamenteve janë shënuar sipas kohës kur kanë dhënë ndihmesën.)

Ky libër u shkrua në bazë të konsultimeve edhe me anëtarë të grupeve të ndryshme etniko-kulturore dhe komuniteteve të ndryshme në gjithë Kanadanë. Ne jemi mirënjohës për ndihmën e të gjithë atyre që morën pjesë në këtë proces, dhe i falënderojmë ata për ndihmesën e dhënë.

Rreth kësaj broshure.

Kjo broshurë i drejtohet grave imigrante dhe refugjate që vuajnë nga keqtrajtimi në një marrëdhënie ose në familje. Nëse njihni ndonjeri që keqtrajtohet, atëherë ju lutemi jepjani këtë broshurë. Pyeteni në se ka nevojë për ndihmë dhe i thoni se nuk është e vetme.

Megjithëse kjo broshurë është shkruar për gratë e imigrantëve dhe refugjatëve, është njëlloj keq edhe kur jan burrat ata që keqtrajtohen. Prandaj nxiten që të kërkojnë ndihmë të gjithë ata që vuajnë nga keqtrajtimi.

Lexuesit

Si grua dhe imigrante, ju mund të ndiheni e vetmuar. Mbase keni vështirësi për të komunikuar me njerëzit. Nëqoftëse dikush ju keqtrajton, ka të ngjarë që edhe të jeni e trembur për jetën tuaj dhe të fëmijëve.

Ndoshta keni nevojë të njiheni më mirë me ligjet kanadeze, me të drejtat tuaja në këtë vend, dhe me ndihmën që iu ofrohet në rast se dikush ju keqtrajton.

Ç'farë përbën abuzim?

Abuzim janë të gjitha rastet kur dikush ju lëndon apo ju trajton keq.

Abuzimi mund të jetë fizik, emocional, psikologjik ose financiar. Një njeri mund të bjerë viktimë e më shumë se një lloj abuzimi.

Zakonisht abuzues është bashkëshorti, ish-bashkëshorti, i dashuri, ish i dashuri. Në disa raste aim und të jetë pjestar i familjes, njerëz të tjerë, ose pjestarë të familjes së bashkëshortit. Abuzuesi mund të jetë mashkull ose femër.

Ja disa shembuj të dhunës fizike

- Goditjet
- Pickimet
- Shuplakat
- Shtyrjet
- Shpimet
- Shkelmimet
- Djegiet
- Goditja me armë
- Therrja ose prerja me thike

Në Kanada këto konsiderohen krime.

Keqtrajtim seksual është: Prekja seksuale ose veprimtaria seksuale kundër dëshirës

Në Kanada ky është krim.

Në rast urgjence

Sapo te keni mundësi, telefononi menjëherë policinë ose ndonjë të afërm.

Dilni jashtë shtëpisë me vrap, nëqoftëse e gjykonit se kështu do të jeni më të sigurt dhe ka njerëz të tjerë që iu shohin.

Bërtisni - sa më fort që t'iu dëgjojnë fqinjët, të cilët do të kenë kështu mundësi të thërrasin policinë.

Keqtrajtimi emocional dhe psikologjik mund përfshijë:

- Kërcënimet për t'iu dëmtuar ju ose dikë ndonjë të afërmin tuaj
- Prishja e sendeve tuaja, lëndimi i kafshëve shtëpiake që mbani, ose kërcënimi për ta bërë diçka të tillë.
- Ndjekja pa dëshirën tuaj (abuzim kriminal)

Në Kanada këto konsiderohen krime.

Ja disa shembuj të abuzimit financiar:

- Përvetësimi i çeqeve që iu përkasin ju
- Mbajtja e parave, në mënyrë që të mos jeni në gjendje të paguani për diçka që ju duhet ju vetë apo fëmijëve tuaj, si për shembull ushqim, strehë, ose kujdes mjekësor

Në Kanada këto konsiderohen krime.

Të tjera forma të keqtrajtimit mund të mos jenë krime, por përsëri mbeten të papranueshme dhe askush nuk ka të drejtë t'iu bëjë gjëra të tilla. Disa shembuj:

- Përçmimi
- Fyerja
- Injorimi
- Të bërtiturit
- Sharjet me fjalë të ndyra
- Izolimi nga miqtë e të afërmit e familjes
- Diktati se ku të shkoni, çfarë të bëni dhe me kë të shoqëroheni
- Mos lënia e parave në përdorim

Mund të kërkon ndihmë

Ka njerëz që mund t'iu ndihmojnë

Telefonojini shoqatës multikulturore ose grupeve që merren me problemet e immigrantëve ose refugjatëve. Pyesni si mund t'iu ndihmojnë. Pyetini se ku tjetër mund të drejtoheni për ndihmë.

Telefonojini policisë. Ata do t'iu mbrojnë ju dhe fëmijët.

Veç këtyre, mund t'iu ofrohen:

- Këshilla dhe ngushëllime
- Strehë e sigurt për të qëndruar
- Ndihmë financiare
- Ndihmë ligjore, që mund të jetë falas
- Ndihmë për t'u larguar – organeve ligjore mund t'i drejtoheni për t'i kërkuar ndihmë për kujdestarinë e fëmijëve, ndihmë financiare, ose shkurorëzimin.
- Marrëveshje për kufizimin e kontaktit të keqtrajtuesit me ju
- Vendime gjyqesh civile apo familjare

Ndihmë mund të merrni edhe nëqoftëse vendosni të qëndroni.

Ku mund të gjeni informacion të mëtejshëm?

- Strehat e grave (për shembull YWCA (Shoqata e Grave të Reja të Krishtera)
- Polici
- Zyra e prokurorit
- Spitalet
- Organizatat shoqërore multikulturore
- Qendrat e grave
- Linjat e posaçme telefonike
- Shoqatat publike ligjore të edukimit dhe informimit
- Shërbimet avokatore ose këshillimore
- Zyrat e ndihmës ligjore
- Mjekët apo infermjeret e shëndetit publik
- Punonjësit shoqërorë


Nuk jeni vetëm

Keqtrajtime ndodhin në të gjitha llojet e familjeve. Ato iu ndodhin edhe kanadezëve, edhe imigrantëve. Ju ndodhin grave me fëmijë dhe grave pa fëmijë, të varfërve dhe të pasurve, nëpunësve, shtëpijakeve, të rejave, të moshuara. Ndodhin me gra të prejardhjeve të ndryshme, besimeve të ndryshme, racave të ndryshme, kulturave dhe grupeve të ndryshme etnike. Keqtratimi mund të kryhen në çdo çast të jetës.

Nuk është faji juaj

Është shumë e vështirë të flasësh për keqtrajtimet. Disa gra kanë turp ose frikë se nuk do t'i besojë familja apo shoqëria. Megjithatë, duhet të keni parasysh gjithmonë se asnjë veprim juaji nuk i jep të drejtën dikujt për t'iu keqtrajtuar. Keqtrajtimet nuk janë asnjëherë të justifikuara. Në asnjë rast nuk është faji juaj.

Shumë gra e dijnë se abuzimet kalojnë përmes një cikli. Tensioni i krijuar rritet derisa keqtrajtuesi vë në përdorim dhunën. Pas shpërthimit të dhunës vjen një periudhë qetësie. Keqtrajtuesi mund të kërkojë falje dhe të premtojë se nuk do ta përsërisë më. Megjithatë, me kalimin e kohës, tensioni mund të rritet përsëri dhe keqtrajtuesi fillon të veprojë sërish dhunshëm. Pra vazhdon cikli i abuzimit.



Fëmijët tuaj kanë nevojë për mbrojtje

Fëmijët e kanë shumë të vështirë kur shohin ose dëgjojnë si keqtrajtohet një nga prindërit. Kjo mund të ndikojë në sjelljen e fëmijëve, në shëndetin fizik ose mendor të tyre, në vlerësimin për veten, si dhe në mbarëvajtjen në shkollë. Gjithashtu mund të ndikojë edhe në mënyrën se si ata shoqërohen me të tjerët. Kur arrijnë një moshë të caktuar, djemtë e rritur në familje të ku ka keqtrajtim, janë të prirur të keqtrajtojnë me bashkëshortet ose me prindërit. Ndërsa vajzat janë më të prirura të pranojnë t'i nënshtrihen keqtrajtimit duke menduar se e tillë është jeta.

Si prind, të qënit viktimë e keqtrajtimit mund t'ua vështirësojë së tepërmi detyrën për t'ua kujdesur për fëmijët. Ndoshta duke parë abuzuesin, fëmijët mund të mendojnë se nuk është e nevojshme që t'iu respektojnë. Nga ana tjetër, ka të ngjarë që abuzimi të jetë me pasoja shtruese për ju vetë, duke ju lënë shumë më pak energji për t'ua kujdesur për fëmijët.

Nëse keqtrajtuesi keqtrajton edhe fëmijët, atëherë duhet të kërkonti patjetër ndihmë. Keqtrajtimi i fëmijëve dënohet me ligj. Ndihmën mund ta kërkonti në qendrën e ndihmave për fëmijët, në agjencitë familjare, pranë organizatave të ndryshme këshillimore, mbështetje ose mendim dhënëse. Fëmijët duhen mbrojtur nga keqtrajtuesit.

Më mirë të qëndroni apo të largoheni?

Në rradhë të parë duhet të mendoni për sigurinë tuaj dhe të fëmijëve. Është normale të trembeni dhe të mendoni se familja ose shoqëria nuk do t'iu përkrahë në veprimet që do të merrni. Edhe kjo mund të ndodhë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë aspak se është më mirë për ju dhe për fëmijët që, për hir të opinionit, të vazhdoni të jetoni në kushtet e keqtrajtimit.

Mund të merrni vendim të largoheni për një kohë të shkurtër. Ose mund të vendosni të largoheni përgjithmonë dhe t'i jepni fund martesës apo marrëdhënies. Mos harroni të pyesni veten:

- A është i rrezikshëm qëndrimi?
- A ju ka vënë dorë edhe më parë abuzuesi?

- A ka armë në shtëpi?
- A ka përdorur ndonjëherë keqtrajtuesi armë si thika apo shkopinj për t'iu rrahur?
- A merr keqtrajtuesi drogë apo alkool me shumicë?

Ç'ndodh nëse vendosni të rrini?

Ndoshta mund ta gjykoni se do është më mirë të mos largoheni.

Nëqoftëse ju kanë lënduar fizikisht, merrni sa më parë ndihmë mjekësore. Nuk ka nevojë të tregoni se kush i ka shkaktuar plagët. Megjithatë, është gjithmonë më mirë për ju t'i tregoni mjekut shkakun e vërtetë të plagëve, në mënyrë që ai të dijë t'iu mjekojë si duhet.

Nuk do të ishte keq të mbanit shënime ose ditar për dëmet që ju janë shkaktuar, si edhe për kohën kur jeni keqtrajtuar, pasi këto mund t'iu ndihmojnë më vonë, nëse vendosni të largoheni. Është gjithmonë më mirë nëse keni një plan të gatshëm po qe se do t'iu duhet të largoheni.

Faqet e para të librit telefonik mund të japin numrat e policisë dhe të gjithë urgjencave të nevojshme. Për ju është e rëndësishme të dini numrin e policisë në rast se keni nevojë për ndihmë. Në rast urgjence, mund të telefononi edhe numrin 911.

Mblidhni sa më shumë të dhëna, si për shembull adresa, numra telefonash të njerëzve të ndryshëm ku mendoni se mund të gjeni mbështetje. Po të keni mundësi, vini edhe para më njanë.

Mundohuni të merreni me diçka që ju bën të ndjeheni mirë. Po të ndiqni këshillat e specializuara mund të arrini të mësoni ndonjë profesion të ri. Kërkoni familje apo shoqata që mund t'iu ndihmojnë.

Nëse keqtrajtuesi dëshiron të ndryshojë mënyrën e sjelljes, ai mund të kërkojë këshillim. Me ndihmë, në afate kohore të gjata, shumë burra kanë arritur ta kuptojnë se i duhet dhënë fund dhunës. Sidoqoftë burrat që janë të dhunshëm, e kanë shumë e vështirë ta ndryshojnë mënyrën e sjelljes. Zakonisht, keqtrajtimi shtohet me kalimin e kohës.


Kush e merr kujdestarinë e fëmijëve?

Edhe kur largoheni nga një mjedis keqtrajtues keni të drejtë të kërkonti kujdestarinë e fëmijëve.

Po të mendoni se fëmijët janë në rrezik, merrini me vete kur të largoheni. Bëni menjëherë kërkesë në mënyrë që të fitoni vendimin e gjykatës për kujdestarinë ndaj fëmijëve. Do të përfitoni shumë nga ndihma e avokatit. Ata mund t'iu ndihmojë t'i kërkonti gjykatës që babai i fëmijëve të paguajë ndihmën e financiare për ju dhe fëmijët. Gjykata do të vendosë gjithmonë në dobi të fëmijëve.

Kur të fitoni të drejtën e kujdestarisë mbi fëmijët, i ati mund të ketë të drejtë t'i vizitojë. Mund të kërkonti që gjykata të marrë vendim që kur vjen i ati i fëmijëve për t'i vizituar, për t'i marrë apo për t'i sjellë, të ndodhet aty edhe një i tretë. Nëse jeni të shqetësuar për sigurinë e fëmijëve, avokati mund të kërkojë që vizitat e babait të fëmijët të kryhen nën mbikqyrjen e dikujt tjetër.

Nëse dyshoni se babai i fëmijëve ose dikush tjetër do të përpiqet t'i largojë ata nga shteti ku jetoni, atëherë duhet të lajmëroni menjëherë avokatin. Po ta denonconi një problem të tillë, gjykata mund të kërkojë të mbajë pasaportat e fëmijëve.

Nëse jeni qytetare kanadeze, atëherë duhet t'i telefononi Zyrës së Pasaportave në numrin 1-800-567-6868 ose Shërbimet TTY  në numrin 1-866-255-7655. Kërkojuni të rregjistrojnë emrat e fëmijëve në një listën të veçantë, në mënyrë që nëqoftëse dikush përpiqet të largohet dhe kërkon të sigurojë pasaporta për fëmijët, ata t'iu njoftojnë menjëherë. Nëse keni tjetër nënshitetësi, atëherë lidhuni menjëherë me ambasadën e vendit tuaj dhe kërkojini atyre të mos lëshojnë pasaporta për fëmijët tuaj.

Në rast se keni vendim gjykate për kujdestarinë e fëmijëve, mirë do të ishte ta mbanit një kopje me vete, për çdo rast. Një kopje tjetër mund t'ia jepni shkollës së fëmijëve.

A ju heqin nga Kanadaja po t'i shmangeni gjendjes abuzive?

Po të jeni nënshetase kanadeze ose banore e përhershme, atëherë askush nuk iu detyron dot të ktheheni në vendin tuaj pas përjetimit të një situatë keqtrajtimi. (Nganjëherë, banorët e përhershëm – permanent residents – quhen edhe imigrantë të zbarkuar – landed immigrants). Po të mos e dini a jeni qytetare kanadeze apo banore e përhershme, telefonojini zyrës më të afërt që merret me këtë problem. Numrin e kësaj zyre mund ta gjeni në faqet e kaltërta të numeratorit telefonik nën emërtimin “Citizenship and Immigration.”

Në rast se jeni gjykuar si refugjate apo si njeri që ka nevojë për mbrojtje, mund të bëni vetë kërkesë për t'u bërë banore e përhershme. Nëse jeni në vartësi të një refugjati apo të një njeriu që ka nevojë për mbrojtje dhe që ka bërë kërkesë për t'u bërë banor i përhershëm për të dy ju, atëherë ai mund ta tërheqë kërkesën. Në këtë rast, mund të ju mund të bëni kërkesë për statusin e banores së përhershme në bazë të motiveve humanitare ose të mëshirës. Do t'iu duhet të provoni qartë se përse jeni e detyruar të qëndroni në Kanada, por nuk ka asnjë garanci se do t'ia dilni mbanë.

Nëse keni bërë kërkesë për mbrojtje si refugjat dhe këtë kërkesë e keni të përbashkët me keqtrajtuesin, atëherë mund të kërkonti që të dy kërkesat të ndahen. Në këtë rast, do të gjykoheni veçmas dhe do të merrni vendim të veçantë.

Ndoshta do t'iu duhet të merrni këshilla ligjore. Po vendosët të paguani dikë që t'iu ndihmojë, ky njeri duhet të jetë jurist, student i drejtësisë që mbikqyret nga një jurist, anëtar i Dhomës së Noterëve të Kuebekut, ose anëtar i Shoqatës Kanadeze të Këshilltarëve të Imigracionit. Për më tepër informacion telefonojini Qendrës lokale të Imigracionit të Kanadasë. Shfletoni faqet blu nën titullin Qytetaria dhe Imigracioni.

A ju heqin nga Kanadaja nëqoftëse prishet sponsorizimi?

Po të jeni imigrante e sponsorizuar nuk do t'iu kthejnë në vendin tuaj vetëm për faktin se sponsori nuk iu sponsorizon më. (Shih edhe *Ndihmë Financiare*)

Çfarë ndihme mund t'iu ofrohet?

Policia

Mund t'i telefononi policisë në rast se keqtrajtuesi iu sulmon ose thotë se do ta kryejë një veprim të tillë. Policia vjen. Shumë oficerë të policisë janë të stërvitur dhe dijnë si të veprojnë në rastet e marrëdhënieve keqtrajtuese në familje apo marrëdhënie të tjera. Ata mund t'iu çojnë në spital, nëse do të keni ndevojë për t'u mjekuar apo për t'u vizituar te mjeku. Ata do t'iu ndihmojnë të largoheni e qetë.

Strehat e grave

Nëqoftëse nuk keni asnjë vend tjetër ku të shkoni, mund t'i drejtoheni ndonjë strehe për gra. Këto janë vende të sigurta ku mund të qëndroni ju dhe fëmijët për disa ditë ose edhe për disa javë. Në vartësi të gjendjes financiare, mund t'iu kërkohet të paguani një pjesë të qëndrimit.

Përherë do të keni pranë punonjës vullnetarë që do t'iu këshillojnë dhe informojnë si duhet. Ata do t'iu ndihmojnë të siguroni ndihmën e nevojshme ligjore, ndihmën financiare, si edhe për të gjetur një banesë të re ku të jetoni, nëse e dëshironi këtë. Gjithashtu aty do të gjeni ushqim, pelena për fëmijët, nëse jeni larguar me nxitim dhe nuk keni pasur mundësi të paketoni kur keni ikur. Ata nuk do t'i tregojnë keqtrajtuesit ku ndodheni.

Këto streha drejtohen nga komunitete të ndryshme. Numrat e tyre mund të gjenden në numërorin telefonik. Numrat mund të gjenden që në faqet e para të listës së urgjencave. Strehat nuk do t'iu japin asnjë të dhënë keqtrajtuesit në lidhje me vendodhjen tuaj. Por këtyre strehave mund t'iu telefononi edhe thjesht për t'u këshilluar. Madje nuk keni nevojë as të tregoni si quheni.

Ndihmë Financiare

Mund t'iu nevojitet ndihmë shoqërore ose financiare. Si banore e përhershme ose nënshitetase, keni të drejtë të bëni kërkesë për një ndihmë të tillë. Por edhe po të mos jeni, mund të bëni kërkesë. Provinca dhe territore të ndryshme kanë rregulla të ndryshme në lidhje me zbatimin e ndihmës financiare. Telefonojini zyrës së zonës ku jetoni për të marrë të dhëna më të sakta për këtë pikë.

Po të jeni imigrante e sponsorizuar, sponsorizuesi duhet të jetë burimi i parë financiar për ju, por nëqoftëse priset sponsorizimi, atëherë mund të përfitoni ndihmë financiare nga shteti.

Nëse atë periudhë merrni ndihmë financiare si Refugjate e Ndihmuar nga Shteti ose si Refugjate e Sponsorizuar Privatisht, ndihma nuk iu anulohet sepse po largoheni nga një gjendje ku keqtrajtoheni. Shteti ose grupi privat sponsorizues do të vazhdojnë t'ua plotësojnë nevojat për aq kohë sa të keni të drejtë të përfitoni. Lidhuni me Qendrën e Imigracionit të Kanadasë, me sponsorin privat ose me agjencinë që ofrojnë shërbimin për të mësuar mbi të drejtën që keni për të marrë ndihmën e duhur.

Kur i drejtoheni gjyqit për të përfituar kujdestarinë e fëmijëve, mund të bëni edhe kërkesë që të gjitha shpenzimet e gjyqit t'i paguajë ati, dhe që ky të përgjigjet për financat tuaja dhe të fëmijës.

Çfarë ndodh nëse...?

Çfarë ndodh kur lajmëroni policinë?

Kur zotëron fakte për keqtrajtimin tuaj, policia ngre padi kundër keqtrajtuesit. Policisë duhet t'i tregoni gjithçka rreth keqtrajtimit që keni përjetuar. Policia edhe mund ta arrestojë keqtrajtuesin, nëse bindet se ka fakte të mjaftueshme për ta bërë këtë.

Në rast se keqtrajtuesi arrestohet, atëherë ai mund të qëndrojë në burg për disa orë, derisa të paraqitet në një seancë dëgjimore. Pas kësaj, mund të lejohet të largohet. Atë mund ta mbajnë në burg vetëm nëse gjyqtari mendon se ka arsye të forta.

Kur mendoni se iu rrezikohet siguria, atëherë lajmëroni policinë përpara se ta lënë të lirë. Gjyqi mund të vendosë kushte për lirim. Për shembull, gjyqi mund të vendosë që keqtrajtuesi të mos ketë të drejtë as t'iu takojë dhe as t'iu telefonojë. Nëse keqtrajtuesi nuk i merr parasysh këto kushte, atëherë ai mund të arrestohet përsëri nga policia.

Nëse keni frikë se do të përpiqet t'iu takojë dhe t'iu lëndoje përsëri, atëherë duhet të gjeni një vend të sigurt për të ndenjur, si për shembull, strehat për gratë.

Çfarë ndodh kur keqtrajtuesi paditet nga policia?

Nëse keqtrajtuesi e pranon fajin në lidhje me keqtrajtimin që iu ka bërë ju ose fëmijëve, atëherë gjyqi do ta dënojë me kusht, me burgim ose me kombinim të të dyjave. Keqtrajtuesit mund t'i kërkohet që, si kusht për periudhën e dënimit me kusht, të pranojë të marrë trjtim nga specialistë përkatës. Nëse do të jepet apo jo dënim me burg varet nga një numër faktorësh, si për shembull, a kemi të bëjmë me shkelje për herë të parë, si edhe sa e lartë është shkalla e rrezikshmërisë së keqtrajtimit. Nëse jeni ende e trembur, atëherë shprehjani frikën hetuesit, në mënyrë që të vihen edhe kushte të tjera për lirim gjatë periudhës së dënimit me kusht.

Në rast se keqtrajtuesi nuk e pranon fajësinë, atëherë mund të kërkohet që të dilni dëshmitare në gjyq. Në mënyrë që të shmangni përballjen me keqtrajtuesin, gjyqi mund t'iu lejojë të dëshmoni nga prapa një perdeje, ose nga ndonjë dhomë tjetër, me anë të një rrjeti të mbyllur televiziv. Gjithashtu, mund të kërkoni që gjatë dhënies së dëshmisë të keni pranë njerëz që iu përkrahin dhe iu bëjnë të ndjeheni më e qetë.

Deri në zhvillimin e gjyqit mund të kalojnë muaj. Kur gjyqi e vërteton fajësinë e keqtrajtuesit, ai dënohet. Ju mund të pyesni hetuesit nëse ka shërbime të tjera që iu ofrohen njerëzve në gjendjen tuaj për të qartësuar edhe më tej procesin gjyqësor.

A do ta heqin nga Kanadaja keqtrajtuesin?

Në rast se keqtrajtuesi është nënshtetas kanadez, atëherë ai nuk mund të detyrohet të largohet nga Kanadaja; po të jetë refugjat apo banor i përhershëm, atëherë edhe mund ta kthejnë nëqoftëse gjyqi e vërteton fajësinë për krimin e ushtrimit të dhunës familjare apo për ndonjë krim tjetër. Urdhëri i largimit lëshohet nga një proces dëgjimor i imigracionit, i cili kryehet pas dënimit. Megjithatë, procesi i kthimit mund të zgjasë shumë.

Abuzimi fizik nuk është i vetmi lloj abuzimi.

- A ndodh ndonjëherë që keqtrajtuesi t'iu bëjë fajtores ose t'iu thotë se nuk vleni fare?
- A ju ndalon abuzuesi të keni shoqërinë tuaj?
- A ju ndalon abuzuesi të takoheni me familjarët?
- A ju ndalon abuzuesi të largoheni nga shtëpia?
- A ju tremb me ato që thotë?

Kur iu keqtrajtojnë

- Nuk jeni vetëm
- Nuk është faji juaj
- Ka ndihmë
- Mbron veten dhe fëmijët

Çfarë duhet të merrni me vete kur të largoheni?

Në rast urgjent largohuni sa më shpejt që të jetë e mundur. Mos u mundoni t'iu mbledhni të gjitha plaçkat për t'iu marrë me vete. Vetëm ikni. Por nëqoftëse keni kohë, mundohuni të merrni sa më shumë nga sendet e shënuara më poshtë:

- dokumente të rëndësishme, si certifikata lindjeje, pasaporta, dokumentat e qytetarisë, dokumenta imigracioni, dokumenta të kujdestarisë mbi fëmijët, vendime gjykate (si për shembul, marrëveshje pajtimi) kartën shëndetsore, kartën e sigurimit shoqëror (SIN), madje edhe kartën e tij të sigurimit shoqëror.
- të holla, karta krediti
- librin e çeqeve, librin e bankës, librezën e kursimeve
- numrin e telefonit tuaj, dhe librin e adresave
- ilaçet
- çelësat e shtëpisë
- lejën e drejtimit të automjetit
- lodrat më të dashura të fëmijëve
- veshje për fëmijët për disa ditë
- bizhuteri me vlerë

Nëse keni ndërmend të largoheni, ndoshta do t'iu duhet të paketoni një pjesë të këtyre gjërave dhe t'iu vendosni në një vend të sigurt, duke menduar se do të largoheni me nxitim.

Shprehje të përdorura në këtë broshurë

sulm

Do të konsiderohet sulm një veprim ushtrimi force apo kërcënimi për të ushtruar forcë ndaj një njeriu nga një tjetër pa dëshirën e të parit. (Dëshira e imponuar dhe marrë me force nuk është dëshirë e vërtetë.)

seanca e dëgjimit

Kjo është një procedurë e veprimeve të gjykatës mbas arrestimit të dikujt. Kjo seancë vendos nëse këtij njeriu do t'i jepet liri e kushtëzuar, apo do të mbahet në burg derisa të zhvillohet gjykimi i tij për akuzat e ngritura

ngacmime të nivelit kriminal

Nëse ai iu ndjek apo ju ka kontaktuar, nëse ju ka kërcënuar ju apo fëmijët, ai ka kryer shkelje ligjore që quhet shqetësim i nivelit kriminal

prokurori

Ky është juristi që përfaqëson shtetin. Prokurori përfaqëson çështjen në seancën gjyqësore kur është kryer një krim.

kujdestari

Kur fitoni kujdestarinë e fëmijëve, jeni ligjërisht përgjegjëse për të gjitha vendimet që merren me fëmijët tuaj, si për shembull, rritjen dhe shkollimin e tyre, etj. Kur keni kujdestarinë e fëmijëve, ata jetojnë me ju, por mund të vizitojnë edhe babanë e tyre

ndihmë ligjore

Ndihma ligjore mund të merret nga një avokat apo nga zyra e ndihmës ligjore. Ndihma ligjore mund të jetë falas. Lidhuni me zyrat e mëposhtme për të mësuar ku mund të siguroni ndihmë ligjore, dhe mundësisht ta gjeni atë pa pagesë, si nga shërbimi i avokatëve, zyra e ndihmës juridike, apo zyra e edukimit publik.

urdhër nga gjykata civile apo familjare

Nëqoftëse nuk ndjeheni e sigurt dhe nuk doni t'i kërkonin ndihmë policisë, mund të kërkonin që gjykatat e mësipërme të marri vendim dhe të lëshojnë urdhër ku përcaktohet që keqtrajtuesi duhet të qëndrojë larg jush dhe gjithë familjes suaj. Duhet të kërkonin ndihmë ligjore për t'u informuar rreth procedurave përkatëse.

marrëveshja e pajtimit

Kur jeni e trembur për sigurinë tuaj, ndoshta do t'iu krijohet mundësia të arrini një marrëveshje pajtimi. Kjo marrëveshje është një vendim gjykate që përfshin një sërë kushtesh. Për shembull, keqtrajtuesit mund t'i thuhet se nuk i lejohet t'iu kontaktojë, t'iu shkruajë apo t'iu telefonojë. Nëqoftëse ai nuk iu përmbahet kushteve të përcaktuara në marrëveshje, policia ka të drejtë ta arrestojë. Nëse iu nevojitet informacion i saktë për këtë marrëveshje, atëherë lidhuni me ndonjë avokat.

dënim me kusht

Me këtë nënkuptohet një vendim i gjykatës kriminale që mund të jepet si pjesë e dënimit për fajtorin. Të dënuarit me kusht i jepen një sërë kushtesh për lirim, një prej të cilëve mund të jetë edhe ndjekja e detyrueshme e seancave këshilluese.

Listë e burimeve të komunitetit

Do të bënit mirë të krijonit – paraprakisht – një listë të burimeve komunitare. Veç policisë, ka edhe organizata e agjenci të tjera të shumëllojshme që mund të ofrojnë ndihmë dhe informacion të dobishëm. Kërkojini numrat e kontaktit të agjencive të mëposhtme në faqet e bardha, të verdha dhe blu të numeratorit telefonik. (Sigurohuni që t’i rifreskoni herë pas herë këta numra, pasi ato mund ndryshojnë vazhdimisht.

Burim i dobishëm

Policia

Mund t’iu ndihmojë të vlerësoni shkallën e sigurisë dhe të ndërmerri hapat e nevojshme kundrejt dikujt që po kryen krim

Numri i telefonit

(911 në rast urgjence)

Shoqatat e edukimit ligjor të publikut

Këto mund të japin informacion të përgjithshëm në lidhje me ligjet, sistemin gjyqësor, si edhe të drejtat tuaja si viktimë.

Shërbimet për viktimat

Mund t’iu drejtojnë te këshilltarë dhe t’iu tregojnë për programe dhe shërbime të ndryshme për viktimat e krimeve.

Linjat e krizave

Mund të jenë në gjendje t’iu ndihmojnë me ndërhyrje në rast krize dhe duke iu drejtuar te shërbimet e nevojshme.

Shtëpitë e tranzicionit

Mund të ofrojnë strehë, informacion dhe referenca për gratë që janë viktimat të dhunës bashkëshortore.

Zyrat e Shëndetit mendor

Mund t'iu ofrojnë informacion dhe këshilla për problemet e depresionit, stresit dhe shëndetit mendor.

Organizatat e shërbimeve multikulturore dhe të imigrantëve

Mund të jenë në gjendje t'iu japin informacion dhe t'iu drejtojnë te shërbime të dobishme.

Qytetaria dhe Imigracioni i Kanadasë

Mund t'i përgjigjet pyetjeve për gjendjen dhe procesin e imigracionit, si edhe të japë informacion mbi *Aktin e Mbrojtjes së Imigrantëve dhe Refugjatëve*.

1-888-242-2100

Shërbimet e ndihmës ligjore

Sipas programit të ndihmës ligjore të provincës tuaj, mund të kualifikoheni për të marrë ndihmë falas në çështjet familjare, të imigracionit apo gjyqet civile.

Njerëz te të cilët keni besim

Të afërm, miq, mjekë, ose këshilltarë të ndryshëm fetarë mund të jenë në gjendje t'iu japin mbështetje emocionale dhe praktike.

Të tjerë

Kërkoni për burime të tjera ndihme! Për shembull, mund të kërkoni ndihmë nga një qendër lokale për gratë, në një qendër kujdesi për komunitetin, e kështu me rradhë.

